



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1262 / Prot.

Gramsh, më 28.05. 2024

VENDIM

Nr. 35 Datë 29/05 /2024

Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101 datë 30.11.2022 "Për emërtimin e shkollës së mesme nga "Xhezar Meçi" në "Skënder Buzdra" në Njësinë Administrative Poroçan dhe emërtimin e Qendrës Shëndetësore në Njësinë Administrative Kukur në "Xhezar Meçi"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29.04.2024, bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeversijen vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nënpika 1.7, shkronja "b", neni 54 shkronja"II", dhe neni 55 pika 2 dhe 6 e tij, Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), si dhe shkresës nr.264 datë 21.02.2024 të Zyrës Vendore Arsimore Gramsh ;

VENDOSI

1. Titulli i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101 datë 30.11.2022, të bëhet:

- Për emërtimin e Shkollës së Mesme të Bashkuar në Njësinë Administrative Poroçan nga "Xhezar Meçi" në "Skënder Buzdra" dhe emërtimin e Qendrës Shëndetësore në Njësinë Administrative Kukur në "Xhezar Meçi".

2. Pika 1 e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101 datë 30.11.2022, të bëhet :

- Të miratojë ndryshimin e emërtimit të Shkollës së Mesme të Bashkuar , në Njësinë Administrative Poroçan nga "Xhezar Meçi" me emërtimin e ri "Skënder Buzdra".

3. Pikat e tjera të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.101 datë 30.11.2022 mbeten të pandryshuara.



4. Ngarkohet Kryetari i bashkisë dhe Zyra Vendore Arsimore Gramsh me zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Enis ZANI



Sek. Këshillit ✓



16. 05.2024

REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA

Nr. 574/prot.
1

Elbasan, më 14.5.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.35 datë 29.04.2024, "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 101 datë 30.11.2022, mbi emërtimin e shkollës së mesme nga "Xhezar Meçi", në "Skënder Buzdra", në Njësinë Administrative Poroçan dhe emërtimin e qendrës shëndetësore në Njësinë Administrative Kukur në " Xhezar Meçi" ", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

